



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies  
Lëndore**

**Me datë 17.01.2023**

<b>Vendimet për DISKUTIM PUBLIK</b>					
<b>#</b>	<b>Kandidati</b>	<b>Specializimi</b>	<b>Tema e punimit</b>	<b>Komisioni</b>	
1	Arlinda Avdullahu Pllana	Mës. Tekn.&TI K	Efekti i punës së grupeve të vogla në të nxënit e lëndës së teknologjisë	Kryetar/e	Kastriot Buza
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Florent Bunjaku
2	Sofijë Balaj	Mës. Biologji	Analizë përmbajtësore e tekstit shkollor historia për klasën e X	Kryetar/e	Veli Kryeziu
				Mentor/e	Sedat Baraliu
				Anetar/e	Xhavit Beqiri
3	Iilir Batushaj	Mës. Matematik ë	Roli i Lëndës së Edukatës Qytetare në implementimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve në SHMU	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Vlora Sylaj
4	Gëzim Pollomi	Mës. Biologji	Roli i metodës së ilustrimit dhe demonstrimit në lëndëne Historisë	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Sedat Baraliu
				Anetar/e	Sedat Baraliu

**Kandidati/ja: 1. Arlinda Avdullahu Pllana**

**Tema: Efekti i punës së grupeve të vogla në të nxënit e lëndës së teknologjisë**

### **ABSTRAKT**

Aktualisht teknologjia po luan një rol teje të rëndësishëm në procesin e të nxënit, duke përfshirë të gjitha nivelet e shkollimit. Përdorimi i strategjive, metodave dhe teknikave mësimore nga ana e mësimit duhet të planifikohen mirë, me qëllim të ndihmës se nxënësve të ndërveprojnë në mënyra të ndryshme në raport me mësimit dhe me njëri-tjetrin. Deri vonë në shkollat e Kosovës forma e të mësimit frontal ishte më e dominuar në krahasim me atë të punuarit në grupe. Ky lloj i të mësimit individual i bënte nxënësit të jenë më vetjak, jo bashkëpunues e komunikues ndërmjet vete. Puna me grupe të vogla krijon një mjedis mësimor në të cilin mbështetet të nxënit aktiv. Aplikimi i metodave dhe teknikave të punës me grupe të vogla mundësojnë nxënësve t'i zhvillojnë aftësitë organizuese, zhvillim të shkathësive personale, ngrit cilësinë e të mësimit. Metodatat e diskutimit dhe të punës me grupe të vogla mundësojnë: aktivitet më të madhe të nxënësve, zhvillim të menduarit kritik, bashkëpunim produktive, rritje interesimin për komunikim më efektiv etj. Duke marr parasysh rëndësinë e të punuarit në grupe të vogla atëherë edhe në lëndën e teknologjisë realizimi i punës në grupe të vogla duhet të ketë një rëndësi të veçantë. Prandaj hulumtim është fokusuar në efektshmërinë e punës në grupe të vogla, se sa realizohet qëllimi i punimit, si bashkëveprojnë nxënësit ndërmjet vete dhe si i ndajnë rolet dhe detyrat. Në këtë hulumtim kemi shtjelluar më gjerësisht sa është efektiv mësimit në dhënie e ndihmës për përgjegjësit e marruara nga ana e nxënësve të grupit, dhe se a bëhet më lehtë procesi mësimor nëpërmjet punës në grupe të vogla. Ky hulumtim është realizuar me anë të metodologjisë sasimore dhe cilësore, ndërsa si instrument matës kemi përdorur pyetësor për nxënës dhe intervista për mësimit në dy institucione shkollore, nga SHFMU "Jenorim De Rada" dhe SHFMU "Jeta e Re", në komunën e Ferizajit. Në hulumtim janë përfshirë gjithsej 110 nxënës të klasave të teta dhe të nënta si dhe 4 mësimit nga dy shkollat. Nga hulumtimi kemi nxjerr rezultate në ndikimin pozitiv të grupeve të vogla tek nxënësit dhe efektet e përdorimit të këtyre grupeve të vogla gjatë realizimit të procesit mësimorë. Gjithashtu kemi bërë krahasimin e rezultateve të arritura nga të dy institucionet shkollore.

**Fjalët kyçe:** Efekti i punës, grupe të vogla, të nxënit, teknologjia

**Kandidati/ja: 2. Sofijë Balaj**

**Tema: Analizë përmbajtësore e tekstit shkollor historia për klasën e X**

### **ABSTRAKTI**

Pa e njohur të kaluarën nuk mund ta krijojmë të ardhmën, lënda e historisë mësohet në arsimin e detyrueshëm dhe paraqet një bazë shumë të rëndësishme për nxënësin dhe teksti i duhur adekuat dhe i përshtatshëm paraqet një tematikë shumë të rëndësishme ku këtë do ta trajtojmë në këtë punim masteri.

Hulumtimi i kësaj teme në këtë kohë është i rëndësishëm për arsye se mund të shërbejë si referencë për ata studiues të cilët dëshirojnë të hulumtojnë rreth kësaj çështje. Teksti është mjet i punës esenciale në procesin mësimor, andaj struktura dhe përmbajtja kanë një rëndësi shumë të madhe. Në këtë punim do të analizojmë tekstin e historisë nga ana përmbajtësore.

Pyetjet e hulumtimit 1. Sa ndimon lënda e historisë në zhvillimin kritik të nxënësve të klasës së X? 2. A i ndimonë teksti i lëndës së historisë së klasës X nxënësit të rrisin njohuritë lidhur me ndikimin e miteve dhe legjendave të ndodhura në kohën antike? 3. A është e përshtatshme historia e klasës së X dhe a është në harmoni me kurrikulën lëndore? Hipotezat e hulumtimit H1: Lënda e historisë ndimon në zhvillimin kritik të nxënësve të klasës së X-të. H2: Teksti lëndës së historisë së klasës X i ndimonë nxënësit e klasës së X të rrisin njohuritë lidhur me ndikimin e miteve dhe legjendave të ndodhura në kohën antike.

Për realizim të kësaj punime do të përdorim metoda mikse, duke filluar nga ajo historike, krahasuese dhe analitike. Gjithashtu për të vërtetuar hipotezat do të realizojmë një hulumtim empirik, i cili do të realizohet në dy dimensione, me mësimdhënës dhe me nxënës. Në këtë mënyrë do të shohim këndvështrimet e të dy palëve të involvuara në proces lidhur me përmbajtjen e librit të historisë së klasës së X-të. Instrumentet të cilat do të përdoren për mbledhjen e të dhënave, disa nga to janë: pyetësorët si instrument kryesor, të cilët do të realizohen me nxënësit, mësimdhënësit pyetjet e të cilëve do të hartohen në bazë të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të cilat i kemi ngritur për temën e kësaj punimi. Hulumtimi do të realizohet me nxënësit e klaseve të 10-ta në komunën e Prishtinës. Në hulumtim do të përfshihen 100 nxënës.

**Fjalët kyqe: Histori, Vlerësim, Përceptim, Kurrikul**

### **Kandidati/ja: 3. Ilir Batushaj**

Tema: Roli i Lëndës së Edukatës Qytetare në implementimin e të drejtave dhe lirive të fëmijëve në SHMU

#### **ABSTRAKTI**

Nevoja për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve buron nga fakti se ata paraqesin një grup shoqëror shumë të ndjeshëm që shumë lehtë mund jetë pre e keqtrajtimit dhe dhunës. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë i kanë të drejtat e njëjta – kanë të drejtë për shkallën maksimale të mundshme të shëndetit, të drejtë për tu shkolluar falas, liri për ta shprehur mendimin e tyre dhe për tu dëgjuar. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për edukim të mirë. Prindërit e tyre dhe edukatorët e tjerë nuk duhet të përdorin dhunë, t'i keqtrajtojnë dhe t'i keqpërdorin fëmijët. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë për ndihmë dhe mbrojtje të veçantë gjatë luftërave dhe emigrimit. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga puna shfrytëzuese dhe keqpërdorimi seksual. Ata kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe të jenë kontakt me të dy prindërit, nëse ato nuk jetojnë bashkë. Fëmijët dhe të rinjtë e hendikepuar kanë të drejtë për një mbështetje të veçantë, si dhe për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore. Sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe në pajtueshmëri me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, “fëmijë” konsiderohet qenia njerëzore nën moshën 18 vjeçare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përfshirë në kuadër të saj Konventën për të Drejtat e Fëmijës, duke ofruar në këtë mënyrë bazë për një rregullim të mjaftueshëm ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Ligji Kundër Diskriminimit, ndalon diskriminimin direkt dhe indirekt kundër çdo personi. Qëllimi i këtij studimi do të jetë të kuptojmë se si qëndron situata me liritë dhe të drejtat e fëmijëve në botë, me theks të veçantë në Kosovë. Kemi për qëllim që të shohim nga pikëpamje të ndryshme se a ka ndryshuar çasja e institucioneve ndaj lirive dhe të drejtave të fëmijëve. Për realizimin e studimit do të përdoret metoda kuantitative apo sasiore. Pyetësi do t'u shpërndalet secilit mësues dhe nxënës prej nga më pas do të nxjerrim të dhënat e nevojshme për hulumtimin tonë.

**Fjalët kyçe:** liritë, të drejtat, fëmijët, konventa, në botë, Kosovë.

## **Kandidati/ja: 4. Gëzim Pollomi**

Tema: **Roli I metodës së ilustrimit dhe demonstrimit në lëndë Historisë**

### **ABSTRAKTI**

Metodat pamore, ku bëjnë pjesë metodat e ilustrimit dhe e demonstrimit përdorin mjete si posterat, fotografitë, hartat, vizatimet, animacionet etj., për të shpjeguar një koncept apo njësi. Përdorimi i tyre është i gjerë, për shkak se është provuar se janë efikase në përmirësimin e të nxënësve në çdo lëndë, përfshirë edhe lëndën e Historisë.

Qëllimi kryesor i punimit ka qenë të tregohet se sa ndikojnë metodat e ilustrimit dhe demonstrimit në përmirësimin e rezultateve të nxënësve në lëndën e Historisë. Hipoteza qendrore e hulumtimit ishte se Metoda e ilustrimit dhe demonstrimit ndikojnë në përmirësimin e të nxënësve/rezultateve të nxënësve në lëndën e Historisë.

Hulumtimi u realizua me 50 nxënës të klasëve VI-IX dhe 15 mësimdhënës të Historisë nga katër shkollat e Komunës së Podujevës. Mostra është përzgjedhur me metodën e qëllimshme. Për mbledhjen e të dhënave primare janë përdorur disa instrumente: para-testi, pas-testi, vëzhgimi në klasë dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Për analizën e të dhënave sasore është përdorur metoda e analizës përshkruese statistikore ndërsa për të dhënat cilësore, metoda e përmbajtjes.

Rezultatet vërtetuan hipotezën qendrore, pasi mesatarja e grupit eksperimental (të cilët kanë punuar me metodat e ilustrimit dhe demonstrimit gjatë fazës eksperimentale) në pas-test ishte më e lartë se ajo e grupit të kontrollit (të cilët kanë punuar me metoda tradicionale),  $M=52$  dhe  $M=75$ , respektivisht. Grupi eksperimental ishin më të motivuar, më të angazhuar në klasë dhe më efikas në përgjigjet e dhëna gjatë diskutimeve në klasë.

Rezultatet treguan se përdorimi i metodave të ilustrimit dhe demonstrimit nga ana e mësimdhënësve nuk është i madh, kjo për arsye se mungojnë mjetet e punës, shkollat nuk janë të pajisura me kabinete dhe me teknologji, ka mungesë të informacionit për zbatim të këtyre metodave etj. Me këto kufizime, mësimdhënësit përdorin më shumë metodat tradicionale, ndonëse efikasiteti i tyre është më i ulët.

**Fjalët kyçe:** metoda, ilustrimi, demonstrimi, nxënësi, lënda, Historia